



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-12652/25
Kaçanik, 09.06.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **VI (gjashtë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 09 Qershor 2025 (E hënë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 11:00. Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-I Pavarur, Betim Shala-LDK, Arben Thaqi-OJQ. Në takim mori pjesë Fatmir Çaka – Koordinator për Rini (DKRS), Lumbardh Malsiu - Zyrtar për Projekte (DKRS).

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e VI-të (gjashtë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2025, data 09 Qershor, me këtë :

REND PUNE

- 1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
- 2.Aktivitetet rinore dhe sportive në Komunën e Kaçanikut;
- 3.Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri.Në saje të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete,

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?

Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbali ?
Procesverbali i mbledhjes se V-të (pestë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2025, u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Komiteti për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes se V-të (pestë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2025, të datës 20.05.2025 / Lënda: 01Nr. 60/01-10879/25.

2. Aktivitetet rinore dhe sportive në Komunën e Kaçanikut;

z.Ekrem Livoreka: Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin:

z.Fatmir Çaka: Siç jeni njoftuar në Kuvend, drejtorja jonë e ka përgatitur plan-programin për vitin 2025, i cili synohet të realizohet përmes aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive. Për këtë qëllim, bëjmë thirrje për pjesëmarrje klubeve sportive, OJQ-ve rinore e kulturore, si dhe shoqërive të tjera që kontribuojnë në këto fusha.

Thirrja e parë publike është shpallur 11/02/2025. Ajo përfshin edhe planin e punës së drejtorisë, përmes të cilit janë formuar komisione të ndryshme.

Ndër to është: Komisioni për vlerësimin e aplikacioneve të OJQ-ve, i përbërë nga 3 zyrtarë komunalë dhe 2 përfaqësues nga shoqëria civile. Përfaqësuesit nga shoqëria civile përzgjidhen përmes një thirrjeje publike.

Komisioni i ankesave, i cili trajton ankesat e aplikantëve që nuk janë përzgjedhur fitues.

Në thirrjen e parë për fushat e rinisë dhe sportit, kanë përfituar gjithsej 9 aplikantë.

Në fushën e kulturës, kanë përfituar 3 shoqëri kulturo-artistike. Këto të fundit përfitojnë përmes subvencionimit të programeve të OJQ-ve, si dhe përmes mbështetjes nga programet të drejtorisë. Për ta kuptuar më mirë subvencionimin e plan-programit të shoqërive kulturo-artistike, përveç aktiviteteve të tyre tradicionale (si "Java e Mërgimtarëve"), ato mbështeten edhe në pjesëmarrje në festivale të ndryshme brenda dhe jashtë Kosovës. Për këto aktivitete, është ndarë një buxhet prej 110,000 euro.

Pasi jo të gjithë aplikantët përfituan në thirrjen e parë, është shpallur edhe thirrja e dytë, më 14.04.2025. Nga kjo thirrje, përfituan 7 OJQ sportive dhe Shoqata e Pensionistëve.

Ndonëse dikush mund të pyesë pse përfiton Shoqata e Pensionistëve, sqarojmë se në plan-programin e drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport përfshihet edhe "Dita e të Moshuarve" (1 Tetori). Për këtë ditë organizohet një aktivitet njëditor që përfshin shoqëri kulturo-artistike dhe pensionistë, me program kulturor në palestrën sportive dhe një koktej rasti për të gjithë të pranishmit.

Në kuadër të drejtorisë funksionojnë këto komisione: Komisioni i vlerësimit, Komisioni i ankesave, Komisioni monitorues, i cili përcjell zbatimin e aktiviteteve të mbështetura nga thirrjet publike.

Disa nga aktivitetet që kanë nisur janë: Dita e Tokës, Dita e Librit, 1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve. Këto aktivitete zhvillohen me pjesëmarrjen e OJQ-ve që kanë aplikuar ose janë bashkëngjitur programit tonë. OJQ-të dhe ekipet sportive gjithashtu marrin pjesë në gara të ndryshme brenda Kosovës. Ne, si drejtori, përmes komisionit të monitorimit, bashkëpunojmë ngushtë me të gjitha organizatat për të siguruar një organizim të suksesshëm dhe korrekt të aktiviteteve.

z.Lumbardh Malsiu: Sa i përket subvencioneve dhe ndihmesës në sport, dihet se kjo është e qartë, duke marrë parasysh se çdo vit është në rritje vlera e subvencionimit. Në thirrjen e parë janë shpenzuar 77,000 euro, ndërsa në thirrjen e dytë 23,000 euro. Totali i mjeteve të shpenzuara është 100,000 euro, ndërsa mbetja buxhetore është 9,000 euro. Sa i përket pjesës financiare, kjo është gjendja aktuale.

znj.Arta Avdiu: A duhet të jetë shuma 110.000 euro?

z.Lumbardh Malsiu: Do të thotë që për një shumë prej 300 eurosh, nuk janë 10.000 euro mbetje, por 9.756 euro. Për këtë shumë të mbetur do të organizohet edhe një thirrje e re thirrja e tretë.

znj.Lejla Çaka: Cilat janë kushtet që duhet të plotësojë një aplikues për të përfituar?

z.Fatmir Çaka: Në thirrjet publike janë të përcaktuara qartë kriteret. Së pari, duhet të jetë i kompletuar dokumentacioni dhe organizatat duhet të jenë të regjistruara pranë Departamentit për OJQ.

Ne si drejtori, kryesisht i përkrahim OJQ-të që zhvillojnë aktivitetet e tyre brenda komunës sonë dhe që i përshtaten plan-programit të drejtorisë.

z.Lumbardh Malsiu: Baza ligjore e thirrjes janë dy rregullore: Rregullorja komunale për ndarjen dhe transferimin e subvencioneve, Rregullorja e Ministrisë.

Përmes harmonizimit të këtyre dy rregulloreve krijohet thirrja publike dhe pastaj vazhdohet me procedurat për formimin e komisionit.

z.Arben Thaçi : Çështja e kriterëve të aplikimit ajo që më ka penguar dhe më pengon ende sot, është fakti që përfaqësuesit e OJQ-ve dhe të shoqatave joqeveritare përfitojnë mjete pa pasur kriterë të qarta as për masivitetin, as për cilësinë.

Nuk ekziston një kriter i tillë që lejon llogaridhënie të qartë për fondet që shpërndahen. Shpesh, ndodh që disa OJQ marrin subvencione dhe qëndrojnë në nivelin më të ulët të garave sportive, pa arritje konkrete.

Me ndërtimin e sallës së sportit kam besuar se sporti në komunë do të ecë shumë përpara, sepse janë krijuar kushte të mira. Është një sallë që i plotëson të gjitha standardet.

Sa i përket ndarjes së subvencioneve, nëse i referohemi rregullores së Ministrisë dhe rregullores komunale, ekziston një problem ligjor: Nuk e kuptoj si është e mundur që një shoqatë e pensionistëve të përfitojë nga fondet e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Shoqatat e pensionistëve janë pjesë e mirëqenies sociale dhe nuk kanë të bëjnë as me sportin, as me të rinjtë, sepse i përkasin moshës së shtyrë. Nëse flasim për humanitet, kjo është çështje tjetër mund të ketë ndihmë përmes bashkëpunimit të ndërsjellë, por jo si subvencion në aspektin ligjor.

Më herët ka qenë edhe rasti i organizatës BONEVET, e cila është subvencionuar. Janë disa organizata që nuk e kanë të qartë bazën ligjore për subvencionim, por megjithatë janë përkrahur nga komisionet si ato të brendshme, ashtu edhe të jashtme të cilat i kanë vlerësuar si të përshtatshme.

Unë jam përfaqësues i një shkolle futbollit, dhe kemi pasur komunikim për çështjen e subvencionimit. Jam e vetmja shkollë që kam aplikuar, i kam plotësuar të gjitha kriteret dhe jam organizatë e regjistruar si OJQ. Ende nuk kemi marrë asnjë vendim nga Ministria apo Drejtoria, lidhur me kalimin tonë në statusin e shoqërisë aksionare.

Arsyetimi që nuk jemi subvencionuar ka ndryshuar në vazhdimësi. Më parë ishte një arsye, tani është një tjetër. Kjo për mua është qasje e gabuar.

Në komunat e tjera të Kosovës si Hani i Elezit, Vitia, Drenasi shkollat e futbollit subvencionohen rregullisht. Por në Kaçanik, shkolla jonë nuk është përfshirë, dhe ju si drejtori dhe si komision e dini arsyen ndoshta bazuar në raportin e komisionit që ka bërë vlerësimin.

Unë dua që sporti në Komunën e Kaçanikut të ecë përpara. Por pa kriterë të qarta dhe pa vlerësim të drejtë të kërkesave, është e sigurt që do të ketë regres. Ka organizata që në aplikim deklarojnë të hyra të mëdha të jashtme edhe pse ato nuk zhvillojnë asnjë aktivitet në Kaçanik dhe përsëri përfitojnë.

Ka raste që kanë marrë fonde nga federatat, nga projekte të mëdha, apo donatorë të huaj, dhe përsëri janë subvencionuar me mjete komunale. Ndërkohë, fëmijët nga familjet me

kushte të vështira nuk mund të përballojnë as pagesën mujore për të marrë pjesë në aktivitete sportive dhe këta nuk subvencionohen fare.

Sa i përket aktiviteteve rinore dhe kulturore, mendoj se duhet të organizohen ngjarje më të mëdha, për të tërhequr më shumë qytetarë të Kaçanikut. Kjo do të ndikonte që njerëzit të mos kenë nevojë të shkojnë në Ferizaj për të ndjekur aktivitete sportive apo kulturore.

z.Lumbardh Malsiu: Sa i përket rastit të Arbenit, përgjegjës ka qenë komisioni dhe i kanë dhënë përgjigje zyrtare pse është refuzuar.

Për pjesën e organizimit që e përmende te të rinjtë, institucioni është përgjegjës t'i ndihmojë organizatat, por jo t'ua përcaktojë planin e aktiviteteve që do të ndërmarrin. Nëse OJQ-të kanë aplikuar me programe të caktuara, ne si institucion nuk mund t'i detyrojmë me çka të aplikojnë. Shumica e aplikimeve janë mbështetur, sipas asaj që kanë propozuar vetë. Për shembull: Ka pasur aktivitete për të rinj, si murale, Aktivitetet e KVRL-së, Sporti shkollor, që parashihen në kuadër të pjesës rinore.

Ndërsa sa i përket festivaleve, shoqëria që ka aplikuar është përpjekur të ruajë një traditë. Sipas informacioneve që kemi, bëhet fjalë për të vetmin festival që ruan këngën popullore, dhe ata kanë bërë kërkesë edhe në Ministri për ta mbrojtur si vlerë kulturore. Nuk ka pasur ndonjë OJQ që ka aplikuar me program për të rinj, dhe që nuk është mbështetur nga ne. Për aktivitetin e javës së diasporës, të gjitha aplikacionet që kanë ardhur për atë pjesë, janë munduar të mbështeten, varësisht nga mundësitë financiare që i ka pasur institucioni.

znj.Arta Avdiu: Për palestrën sportive ende nuk është bërë emërimi. A ka ndonjë zhvillim se ku do të emërohet palestra sportive.

z.Fatmir Çaka: Kjo çështje shkon përmes Drejtorisë me një propozim, dhe Kuvendi merr vendim për emërimin.

3.Të ndryshme:

z.Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 12:14.

Procesmbajtës
Mavije Murseli

